

Vota ABSTENIM : s'ka

### **Pika 6 e rendit të ditës , “Të ndryshme ”.**

Kryetare e Këshillit drejton pyetjen në se ka pyetje diskutime rreth çështjes “ Të ndryshme”

Me leje fajën e merr Znj. Liri Nuhellari e cila shpreh shqetësimin për urën tek Shkolla “Kahreman Ylli”, kanë rënë dërrasat dhe është shumë vështirë për tu kaluar dhe ka shumë rrezikë për të gjithë kalimtarët.

Me leje fjalën e merr Z.Enver Caka i cili shpreh disa shqetësime:

1-Për riparimin e varrezave të patriotëve te varrezat publike dhe varrezat e dëshmorëve.

2-Problemi që ka fshati Orizaj me ujin.

3-Rruga kur shkon për tek Sandri nga përroi e lartë duhen vendos bordura sepse janë prishur.

4-Për plotësimin e komisionit për Dhënien e Titujve Vendorë të Nderit në Bashkinë Skrapar.

Fjalën e mer Nën/Kryetarja Znj.Xhanina Llango e cila i drejtohet Z.Pëllumb Guri me që është dhe i lagjes se si i duket rruga që po bëhet.

Me leje fjalën e merr Z. Pëllumb Guri i cili shpreh mendimin se shumë bukur por vetëm të ketë më shumë poste parkimi që tju vi në ndihmë të gjithë qytetarëve.

Me leje fjalën e mer Z. Fikret Telha i cili shpreh shqetësim , për një familje në Nishicë për Z. Luan Spahiut i ka shkarë shtëpia, mos ti shohim ca të nënës ca të njerkës, Meqënëse ky problem është ngrit edhe më parë ,në qoftëse nuk ka mundësi ose vënd për ti ngritur shtëpinë të vlerësohet ti jepen lekët.

Fjalën e merr Nën/Kryetarja Znj.Xhanina Llango e cila thot që e ka marë dosjen e Luan Spahiut nga Emergjencat Civile të kompletuar do diskutohet me Kryetarin dhe do bëjmë dicka.

Me leje e merr fajlën Z. Fikret Telha i cili propozon për Z.Enver Caka ti jepet një ndihmë financiare me shumën prej 100.000 lekë të vjetra për kontributin që ka dhënë në këtë qytet, për shkrimet që ka bër por dhe si këshilltar.

Të gjithë këshilltarët shprehën dakortësi.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për “Dhënien e ndihmës financiare për shtetasin Enver Caka” në orën 11:45, Votimi u bë i hapur

Vota PRO: 8, Alma Kadiasi, Edmond Kalem, Elsa Petritaj,Fikret Telha, Mimoza Hysaj, Pëllumb Guri.Skerdilajt Jaupllari,Valbona Gropa.

Vota KUNDER: s'ka

Vota ABSTENIM : s'ka